

|  |   |   |
|--|---|---|
| <b>DHOMA E POSAÇME E<br/>GJYKATËS SUPREME TË<br/>KOSOVËS PËR ÇËSHTJE<br/>NË LIDHJE ME<br/>AGJENCINË KOSOVARE<br/>TË PRIVATIZIMIT</b> | <b>SPECIAL CHAMBER OF THE<br/>SUPREME COURT OF<br/>KOSOVO ON<br/>PRIVATIZATION AGENCY<br/>RELATED MATTERS</b> | <b>SPECIJALNA KOMORA<br/>VRHOVNOG SUDA<br/>KOSOVA O PITANJIMA<br/>KOJA SE ODOSE NA<br/>KOSOVSKU AGENCIJU<br/>ZA PRIVATIZACIJU</b> |
|--|---|---|

29 November 2012

**SCA-09-0042**

**NSH XX, XX**

Perfaqësuar nga

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, Zyra për çështje ligjore, kompleksi TSS,

Prishtinë

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. Ilir Konushevci nr. 8, Prishtinë

*Apeluesi*

Kundër.

**A.A., XX**

përfaqësuar nga avokati XX

*Paditësi*

Kolegji i parë i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i përbërë nga gjyqtari kryesues Alfred Graf von Keyserlingk, Shkëlzen Sylaj dhe Qerim Fazliji, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 29.11.2012, lëshon këtë:

### **Aktvendim**

Apeli kundër aktgjykimit C.No.801/04 të Gjykatës Komunale në Prishtinë hedhet poshtë si i papranueshëm.

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Më 21 maj 2004 paditësi ka parashtruar padi pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës ("Gjykata Komunale") për verifikim se ai është pronar i një lokali afarist (i vendosur në Prishtinë, Qendra e Biznesit Dardania nr.53) në bazë të kontratës së blerjes që ai e kishte nënshkruar me të paditurën NSH-në në vitin 2001. Paditësi deklaron se ai pagoi çmimin e plotë të blerjes të paditurit dhe kishte marrë posedimin mbi pronën, megjithatë, ai nuk kishte mundur ta vërtetojë kontratën në Gjykatën Komunale sepse i padituri nuk i kishte ofruar atij dokumentet e nevojshme të përcaktuara në kontratë.

Më 4 gusht 2005 Gjykata komunale nxori një aktgjykim duke konfirmuar padinë si të bazuar (C.no.801/04). Në procedurën pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës, Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) nuk iu është dorëzuar padia dhe as që ka qenë e ftuar në

seancë dhe as aktgjykimi nuk është dorëzuar tek AKM-ja. Në seancën dëgjimore në të cilën i padituri ka qenë i përfaqësuar nga drejtori i të paditurit E.D. të dyja palët kanë hequr dorë nga e drejta e tyre për ankesë dhe gjykata shpalli aktgjykimin përfundimtar.

Më 21 gusht 2009 AKM-ja në emër të të paditurit parashtrroi në Dhomën e Posaçme një ankesë kundër katër aktvendimeve të Gjykatës Komunale C.no.801/04, C.no.802/04, C.no.811/04 dhe 812/04 fillimisht të regjistruara si SCA-09-0042. Më pas lënda ishte ndarë si më poshtë: SCA-09-0042 ankesë kundër C.no.801/04, SCA-09-0078 ankesë kundër C.no.802/04, SCA-09-0079 ankesë kundër C.no.811 / 04, SCA-09-0080 ankesë kundër C.no.812/04.

AKM-ja pohoi se aktgjykimi ishte përmbysur sepse çështja është nën juridiksionin primar të Dhomës së Posaçme në pajtim me nenin 4.1 (d) të rregullores së Dhomës së Posaçme, rreg. e UNMIK-ut 2002/13. AKM-ja pohon se çështja nuk ishte referuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Komunale dhe për këtë arsye gjykata komunale nuk kishte juridiksion për të gjykuar çështjen. AKM-ja thekson se Gjykata Komunale duhej të jetë deklaruar se nuk është gjykatë kompetente dhe duhej të ketë paraqitur lëndën në Dhomën e Posaçme (në pajtim me nenet 17 dhe 18 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore).

Me parashtresën e 14 qershorit 2012 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) në emër të të paditurit ka deklaruar se aktgjykimi i ankimuar do duhej të anulohet për shkak të mungesës së juridiksionit siç është argumentuar nga AKM-ja. AKP-ja më tej pohon se aktgjykimi i Gjykatës Komunale është i pabazuar, sepse është në shkelje të nenit 6 të Rreg. së UNMIK-ut 1999/1 dhe nenit 9 të Ligjit për Transferimin e Pronave të Paluajtshme në lidhje me transferimin e pronës së NSH.

Më 26 qershor 2012 paditësi deklaroi se argumentet e ngritura nga AKM-ja kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale janë të pabazuara. Sipas mendimit të tij kontrata e shitjes mes palëve është e vlefshme, sepse ishte lidhur me 26 shkurt 2001, e që është para hyrjes në fuqi të rreg. së UNMIK-ut 2002/12 mbi themelimin e AKM-së. Paditësi deklaroi se në kohën e procedurës ai nuk ishte në dijeni se mosmarrëveshja është nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme.

Me urdhër të kolegjit të 8 gushtit 2012 AKM-së dhe AKP-së iu ishte kërkuar që të caktojnë një avokat i cili është anëtar i ndonjë shoqate apo Odës së Avokatëve për t'i përfaqësuar para Dhomës së Posaçme.

Në lidhje me pretendimet e mëtutjeshme të palëve referenca është bërë në dosjen e lëndës dhe në deklaratat e palëve në seancë.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa duhej të refuzohet si e papranueshme.

Ankuesi nuk ishte përfaqësuar sipas rregullit në seancën dëgjimore të datës 30.8.2012.

## **Përfaqësimi i ankuesit nga AKP-ja**

AKP-ja nuk e ka përfaqësuar në mënyrë të duhur ankuesin, sepse vet AKP-ja nuk ishte e përfaqësuar nga një avokat.

Përveç personave fizik, çdo palë para Dhomës së Posaçme duhet të përfaqësohet nga një anëtar i shoqatës apo Odës së avokatëve (shtojca neni 24 i LDHP 04/L-033. Kjo poashtu vlen edhe për NSH-në e përfaqësuar nga AKP-ja. Formulimit të kësaj dispozite i mungon ndonjë indikacion se pse ajo nuk duhet të aplikohet. Nenet 73, 74, 85 dhe 86 të Ligjit të procedurës kontestimore (ligji nr.03/L-006, LPK), rregullon se kush mund të jetë palë, cilat veprime mund të ndërmerren një palë dhe kush mund ta përfaqësojë një palë, lejon që palët dhe përfaqësuesit e tyre të cilët nuk janë avokatë të regjistruar të përfaqësojnë në gjykatë, por në lidhje me këto dispozita, neni 24 i shtojcës së LDHP është Lex Posterior dhe Lex Specialis, i cili zëvendëson dispozitat e LPK. Ligjvënësi nxjerrë nenin 24 të shtojcës të LDHP-së kur LPK tashmë ekzistonte dhe ai rregullohet nga neni i 24 i shtojcës të LDHP-së një procedurë të posaçme në një gjykatë të posaçme, ndryshe nga gjykatat e tjera të Kosovës. Neni 24 i shtojcës të LDHP zëvendëson gjithashtu edhe nenin 29 të ligjit për AKP-në (04/L-034, ligji për AKP-në), për shkak se ai është nxjerrë më vonë dhe nuk e rregullon përfaqësimin në përgjithësi, siç bën ligji për AKP-në por veçanërisht përfaqësimin para Dhomës së Posaçme. Kjo vlen edhe për nenin 29.2 të ligjit për AKP-në i cili rregullon "qëndrimin ligjor" Agjencia për të përcjellë ndonjë të drejtë të një ndërmarrjeje në gjykatën kompetente në emër të ndërmarrjes në fjalë. Edhe kjo dispozitë është zëvendësuar nga dispozitat e veçanta të aprovuara më vonë të nenit 24 të shtojcës të LDHP.

Rregullorja ligjore që personat fizikë nuk kanë nevojë për një avokat, por të gjithë të tjerët kanë nevojë për avokat nuk shkel nenin 73 dhe 74 të LPK. Kjo nuk është e mundur pasi nenet 73 dhe 74 nuk zbatohen. Ata janë zëvendësuar nga neni 24 i LDHP.

Kërkesa që të përfaqësohet nga një avokat nuk është një shkelje e të drejtës kushtetuese të barazisë para ligjit. Ajo mund të mbetet e hapur nëse AKP-ja si një "organ publik" (neni 1.1 i ligjit për AKP-në) mund të deklarohet për të drejtën themelore të barazisë, që është historikisht dhe në kontekstin e saj kushtetues një e drejtë e personave fizikë dhe juridikë privatë kundër shtetit, jo e një të drejte për një organ shtetëror kundër shtetit. I padituri ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të barabartë, por barazia kushtetuese nuk do të thotë të gjithë të trajtohen njësoj, pavarësisht nëse ata janë në mënyrë të arsyeshme dhe në aspekte jo-diskriminuese të diferencimit. Nuk është as e paarsyeshme e as diskriminuese të privilegjojen personat para gjykatës në lidhje me personat juridik (ose një autoriteti publik të shtetit). Shpesh, edhe nëse personat fizikë nuk kanë mjete financiare për të përballuar një avokat. Kjo në aspektin kushtetues është një arsye e mjaftueshme për privilegjimin e tyre për të dalë përpara DHPGJS pa një avokat.

Si rezultat i kësaj mund të thuhet se i padituri, si të gjithë, përveç personave fizikë, duhet të jetë i përfaqësuar para Dhomës së Posaçme nga një avokat i cili është anëtar i një shoqate ose Odës së Avokatëve të përfaqësimit nga AKP-ja e cila u shfaq pa avokat të regjistruar nuk është i vlefshëm.

## **Përfaqësimi i apeluesit nga AKM-ja**

AKM-ja nuk e ka përfaqësuar në mënyrë valide palën e paditur për shkak se AKM-ja nuk ka të drejtë dhe as mandat për të përfaqësuar një NSH të Kosovës mëtutje.

## **Ligji i Kosovës**

Neni 1 i Ligjit për AKP-në (Nr.03/L-067 i ndryshuar me ligjin nr.04/L-034) thotë:

*Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej “Agjencia”) është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj. Agjencia është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë.*

Kjo çështje është sqaruar nga neni 31 Ligji AKP-së, i cili thotë:

*31.1 Ky ligj zëvendëson çdo dispozitë tjetër të së drejtës në Kosovë që është në kundërshtim me të.*

*31.2 Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, e ndryshuar, do të pushojë të ketë efekt juridik në datën që ligji aktual hyn në fuqi.*

*31.3 Agjencia merr përsipër të gjitha detyrimet që ajo ose paraardhësja e saj mund të ketë shkaktuar nën Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12, të ndryshuar. Bordi dhe menaxhmenti i Agjencisë do të përmbushë të gjitha përgjegjësitë e ndonjë Bordi paraardhës ose menaxhmenti të emëruar në bazë të Rregullores 2002/12, të ndryshuar.*

Ligji për AKP-në që e ka zëvendësuar atë për AKM-në nga AKP-në, është ligj valid i Kosovës (aktgjykimi i gjykatës kushtetuese të Kosovës lënda KL nr 25/10 të datës 4 shkurt 2010, paragrafi 55) kolegji pasi gjykata kosovare mban detyrime të detyruar nga ky aktvendim (neni 112.1 i Kushtetutës së Kosovës).

## **Ligji i themeluar nën autoritetin e Kombeve të Bashkuara**

Ligji i tillë i ka dhënë në mënyrë të vlefshme AKM-në me fuqinë për të përfaqësuar NSH-të e Kosovës.

Kapitulli VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara autorizon Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për të marrë masa për sigurimin e paqes. Masa të tilla janë të vlefshme dhe të zbatueshme për të gjithë, pavarësisht nëse është anëtar i Kombeve të Bashkuara apo jo, pra edhe për Kosovën. Nën fuqinë e Kapitullit të VII-të Këshilli i Sigurimit më 10 qershor 1999 miratoi Rezolutën 1244 e cila e vë Kosovën nën

Administrimin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara (UNMIK). UNMIK-u pastaj filloi të administrojë Kosovën sipas rregulloreve të shumta, mes të tjeraveve edhe Rregullores 2002/12 të datës 13 qershor 2002 "Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit", e cila i jep AKM-së fuqinë dhe përgjegjësinë për të administruar ndërmarrjet publike dhe shoqërore të Kosovës. Kjo nënkupton autoritetin për të përfaqësuar ndërmarrjet të tilla.

Më 17.02.2008 Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e Kosovës. Ky akt nuk kishte asnjë ndikim në vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e ligjit bazuar në fuqinë e Kombeve të Bashkuara. Ligji i tillë nuk varet nga pranimi i të adresuarit. Të gjitha vendet, edhe vendet pavarësia e të cilave asnjëherë nuk është kontestuar, i nënshtrohen Ligjit të Kombeve të Bashkuara. Kështu, opinioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës se zbatimi i ligjit të OKB-së është në kundërshtim me pavarësinë e pohuar të Kosovës (nr 53 i arsyetimit të aktvendimit të datës 4.2.2010 në lëndën nr KI 25/10 është keqkuptuar që ligji i OKB-së sipas Kapitullit VII nuk varet nga pranimi. Ky trup gjykues deri në një masë nuk është i obliguar nga arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese për shkak se Gjykata Kushtetuese e Kosovës është autoriteti përfundimtar vetëm për interpretimin e ligjit të Kosovës, e jo ligjit të OKB-së.

Megjithatë, zbatueshmëria e rregullores 2002/12 të datës 13 qershor 2002 ka përfunduar, madje rregullorja dhe gjithashtu rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara nuk kanë asnjë afat kohor.

Rezoluta 1244 nuk e përcakton statusin përfundimtar të Kosovës, por vetëm statusin paraprak. Ajo është bërë vetëm si një hap drejt statusit final. Rregullorja paraprake tanimë zgjat prej 13 vitesh.

Por edhe në kuadër të UNMIK-ut, Administrata e përkohshme ka përfunduar. Në vend të vazhdimit të administrimit të NSH-ve të Kosovës ka mbetur vetëm disa shprehje brengosjeje dhe shfaqje rastësore nga DHPGJS.

Akti i fundit rregullues i UNMIK-ut ishte rregullorja nr. 2008/34 për shpalljen e ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të inspektoratit të punës të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 14 qershor 2008.

Popullsia e Kosovës kishte nevojë për një status të sigurtë të vendit administratë aktuale dhe legjislacion. Në pikëpamje të pamundësisë të Këshillit të Sigurimit për të zgjidhur statusin e përkohshëm të Kosovës dhe mosveprimi i UNMIK-ut për të administruar Kosovën (e cila kërkon më shumë se shprehje të shqetësimit dhe protestës) aktet e legjislaturës së Kosovës janë tani të vlefshme edhe nëse ato bien ndesh me rregulloret e OKB-së lëshuar më parë nga UNMIK-u.

Prandaj kolegji konstaton se AKM-ja është zëvendësuar me AKP –në (neni 1 i AKP-së)

Edhe pse apeluesi në seancën e datës 30.8.2012 nuk ishte përfaqësuar në mënyrë të rregullt dhe nuk mund të lëshohet një aktgjykim në mungesë, sepse paditësi nuk ka kërkuar një aktgjykim kundër apeluesit (neni 52 paragrafët 1 dhe 2 të shtojcës së ligjit No.04 / L -033 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me

Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në vijim: shtojca e LDHP-së). Por nuk kishte asnjë arsye për shtyrje të seancës dëgjimore. Gjykata nuk duhet ta zgjerojë procedurën nëse njëra palë nuk është e përfaqësuar në mënyrë të rregullt dhe pala tjetër nuk ka kërkuar Aktgjykim në mungesë. Një palë që nuk janë përfaqësuar siç duhet dhe pala tjetër nuk kërkon një gjykim në mungesë. Gjykata duhet të nxjerrte vendim sikurse të mos ishte ai në mungesë. Ankesa duhet të ishte hedhur poshtë si e papranueshme.

### **Taksat gjyqësore**

Gjykata nuk do ta ngarkojë me shpenzime paditësin pasi presidiumi i gjykatës deri më tani nuk ka nxjerrë një listë me shkrim e cila është aprovuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (neni 57 2 paragrafi i LDHP-së). Kjo do të thotë se deri tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për të ngarkuar shpenzime.

### **Këshillë ligjore**

Kundër këtij vendimi brenda 21 ditëve mund të parashtrahet apel tek kolegji i apelit i Dhomës së Posaçme. Apeli duhet t'i dorëzohet palës tjetër dhe t'i dorëzohet trupit gjykues **nga apeluesi**, të gjitha brenda 21 ditëve. Apeluesi duhet të paraqesë në kolegjin e apelit dëshmi se i ka dorëzuar apelin edhe palës tjetër.

Afati i përcaktuar kohor fillon në mesnatën e ditës, kur ankuesit i është dorëzuar vendimi me shkrim.

### **Kolegji i apelit do të refuzojë ankesën si të papranueshme nëse apeluesi dështon të paraqesë atë brenda afatit të caktuar.**

I padituri mund të paraqesë përgjigje kolegjit të apelit brenda 21 ditëve nga data kur iu është dorëzuar apeli, duke i dorëzuar përgjigjen apeluesit dhe palës tjetër.

Apeluesi atëherë ka 21 ditë pasi iu është dorëzuar me përgjigje ndaj apelit të tij, t'i dorëzojë kolegjit të apelit dhe palës tjetër përgjigjen e vet. Pala tjetër, pastaj ka 21 ditë pasi i është dorëzuar përgjigja e apeluesit të dorëzojë apeluesit dhe kolegjit të apelit kundër-përgjigjen e vet.

Alfred Graf von Keyserlingk  
Gjyqtar kryesues